



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



# Monitorimi i Investimeve Kapitale, Financuar nga Tarifa e Shërbimit të KRU “Gjakova”, Viti 2023

Verifikimi i përmbushjes së caktut të investimeve kapitale të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2023

Verifikimi i listës së investimeve kapitale të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2023



---

## Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Rëndësia e monitorimit të investimeve kapitale.....	4
3. Metodologjia e punës për monitorimin e investimeve kapitale .....	5
4. Takimet në KRU për monitorimin e realizimit të listës së investimeve kapitale.....	5
5. Investimet e aprovuara për KRU Bifurkacioni .....	6
6. Investimet e realizuara nga KRU-të sipas procesit të auditimit të të dhënave.....	6
7. Monitorimi i listës së investimeve kapitale .....	9
8. Konkluzione .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
9. Rekomandime.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

---

## 1. Hyrje

Investimet kapitale në industrinë e shërbimeve të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura janë thelbësore për të siguruar qëndrueshmërinë, cilësinë dhe furnizimin e qëndrueshëm të ujit për popullatën. Këto investime përfshijnë ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujit, por jo të kufizuara vetëm tek ato, si p.sh.:

1. **Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes së ujit:** Kjo përfshin zëvendësimin e gypave të vjetra dhe instalimin e gypave të reja për të përmirësuar efikasitetin e shpërndarjes së ujit dhe për të reduktuar humbjet e ujit.
2. **Përmirësimi i impianteve të trajtimit të ujit:** Investimet në teknologji të reja për trajtimin e ujit ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe në përputhjen me standardet shëndetësore.
3. **Ndërtimi i rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit:** Këto janë të nevojshme për të garantuar furnizimin e vazhdueshëm me ujë në periudhat e thatësirës dhe për të menaxhuar presionin e ujit në sistem.
4. **Automatizimi dhe monitorimi i rrjetit të ujit:** Implementimi i sistemeve të menaxhimit të inteligjencës për monitorimin dhe kontrollin e rrjetit në kohë reale mund të ndihmojë në identifikimin e problemeve dhe ndërhyrjeve të shpejta për të minimizuar ndërprerjet në furnizim.
5. **Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit:** është një investim kapital i rëndësishëm në infrastrukturën e shërbimeve të ujit dhe ka një ndikim të madh në cilësinë e jetesës, shëndetin publik dhe qëndrueshmërinë mjedisore, si dhe ndikojnë në parandalimin e përmytjeve urbane.
6. **Rritja e kapaciteteve të trajtimit të ujërave të ndotura:** Kjo përfshin ndërtimin e impianteve të reja ose zgjerimin e impianteve ekzistuese për trajtimin e ujërave të ndotura, duke reduktuar ndotjen dhe përmirësuar cilësinë e ujërave natyrore.

Investimet kapitale në këtë sektor kanë disa përfitime kryesore:

- **Përmirësimi i cilësisë së jetës:** Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë të pijshëm përmirëson shëndetin dhe mirëqenien e popullatës.
- **Rritja e qëndrueshmërisë mjedisore:** Përmirësimet në trajtimin e ujërave të ndotura dhe menaxhimin e burimeve të ujit ndihmojnë në mbrojtjen e ekosistemeve natyrore.
- **Zhvillimi ekonomik:** Një infrastrukturë e fortë e ujësjellësit është kritike për mbështetjen e zhvillimit industrial, duke kontribuar në rritjen ekonomike të vendit.
- **Reduktimi i kostove afatgjata:** Investimet në teknologji dhe infrastruktura moderne ndihmojnë në uljen e kostove operative dhe të mirëmbajtjes në afatgjatë.

Këto investime kërkojnë planifikim të kujdesshëm, financim të qëndrueshëm dhe mbështetje të fortë politike dhe shoqërore për të arritur qëllimet e dëshiruara, e cila paralelisht kërkon bashkërendim dhe koordinim të aktiviteteve të gjithë palët e interesit në Kosovë.

---

## 2. Rëndësia e monitorimit të investimeve kapitale

Monitorimi i investimeve kapitale në industrinë e shërbimeve të ujësjellësit është një komponent kyç për të siguruar suksesin e projekteve, duke garantuar cilësi, efikasitet dhe transparencë. Ky proces jo vetëm që ndihmon në realizimin e projekteve brenda buxhetit dhe afateve kohore, por gjithashtu kontribuon në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit afatgjatë të infrastrukturës së ujësjellësit.

Raportimi i rregullt mbi realizimin e investimeve kapitale siguron që të gjitha palët e interesit të informohen në mënyrë të rregullt për progresin dhe ecurinë e projektit, dhe në këtë aspekt ARRU angazhohet seriozisht që raportimi dhe realizimi i investimeve kapitale të jetë një proces i vazhdueshëm dhe transparent.

Monitorimi i vazhdueshëm krijon një mjedis të përgjegjshëm, ku të gjithë aktorët përfshirë kontraktorët dhe menaxherët e projektit mbajnë përgjegjësi për detyrat e tyre.

Monitorimit të investimeve kapitale i kanë paraprirë dy aktivitete të nivelit qendror, e cila është kusht pastaj për gjithë sektorin që investimet kapitale të planifikohen mirë dhe monitorimi i tyre të jetë konsistent.

Këto aktivitete janë:

- Shkresa nga Kuvendi i Kosovës, datë 3.08.2022, ku i bën thirrje të gjitha palëve të interesit në Kosovë që:
  - të sigurohet se të gjitha investimet e bëra ndër vite kanë dhënë rezultate konkrete në eliminimin e humbjeve të ujit.
  - Të realizohet auditim specifik i performancës nga ZKA (Zyra Kombëtare e Auditimit) duke pasur në fokus fushën e investimeve kapitale.
  - Të analizohet monitorimi i planit të investimeve kapitale, duke përfshirë edhe planin e veprimit,
  - Etj.
- Raporti i Auditimit të Performancës nga ZKA “Ndikimi i investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe zgjerimin e shërbimeve tek qytetarët nga KRU-të”, i cili ndër të tjera ka dhënë rekomandimet:
  - ARRU duhet të sigurohet se përmes monitorimit po realizohen projektet e investimeve kapitale me kohë,
  - KRU-të duhet të hartojnë Planin e Menaxhimit të Aseteve dhe Planin e Investimeve Afatgjata në mënyrë që të ketë një planifikim të duhur të projekteve kapitale,
  - KRU-të duhet të sigurojnë se investimet kapitale të planifikuara në Planin e Biznesit duhet të jenë të harmonizuara me Biznes Planin Rregullator,
  - Etj.

### 3. Metodologjia e punës për monitorimin e investimeve kapitale

Pikë referuese e analizës së krahasimit të të dhënave të investimeve kapitale për vitin 2023 do të jetë aplikacioni tarifor i KRU-së, dorëzuar në vitin 2021 për vitet e procesit tarifor 2022-2024.

Të dhënat e realizuara do të merren nga Raportet e Auditimit / Verifikimit të të dhënave të raportuara të KRU-së, ku merren për bazë kategoritë e investimeve kapitale sipas Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator.

Lista e projekteve të aprovuara nga ARRU gjatë procesit tarifor krahasohet me listën e projekteve të realizuara nga KRU-ja për vitin respektiv.

Pra, metodologjia e punës analizon të dhënat e investimeve kapitale:

- Verifikimi i përmbushjes së caktimit të investimeve kapitale të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2023, dhe
- Verifikimi i listës së investimeve kapitale, projekt pas projekti, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, për vitin 2023

### 4. Takimet në KRU për monitorimin e realizimit të listës së investimeve kapitale

Për t'u ndërmarr ky aktivitet, Departamenti i Tarifave në kuadër të ARRU-së ka zhvilluar takim në KRU për të diskutuar listën e projekteve të aprovuara me procesin tarifor dhe nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2023.

Me qëllim të monitorimit të investimeve kapitale të aprovuara gjatë procesit tarifor 2022-2024, ARRU, komform mandatit ligjor, ka realizuar takime në të gjitha KRU-të, për të vlerësuar nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2023.

Takimet janë realizuar ndaras me secilën KRU, përkatësisht takimet janë mbajtur me zyrtarë të Departamentit Teknik dhe të Departamentit të Financave të KRU-ve, për të diskutuar listën e projekteve të aprovuara me procesin tarifor dhe nivelin e zbatimit të projekteve për vitin 2023.

Monitorimi i zbatimit të investimeve kapitale nga Departamenti i Tarifave të ARRU është e ndërlidhur edhe me auditimin e të dhënave që ka bërë paraprakisht Departamenti i Performancës. Si vlera të besueshme të investimeve të realizuara janë marrë të dhënat nga procesi i auditimit të të dhënave, të shpërndara sipas kategorive të Udhëzuesit të Kontabilitetit Rregullator.

Më datë 09.08.2024, është mbajtur takimi në zyrat e KRU, ku të pranishëm nga ana e ARRU-së, ishin:

Refik Ramaj	Drejtor i Departamentit të Tarifave
Vehbi Duraku	Analist për asete dhe investime kapitale

Nga KRU në këtë takim ishin:

Visar Hasi	Drejtor Teknik
Shkodran Gaxherri	Specialist për zbatimin e projekteve

---

Ky raport merr për bazë të dhënat e realizuara nga KRU për vitin 2023 në bazë të shënimeve të marra gjatë procesit të auditimit të të dhënave si dhe krahason të dhënat e projekteve të investimeve kapitale, sipas BPRR, duke vlerësuar statusin e realizimit të tyre në bazë të të dhënave të marra gjatë takimit dhe dokumenteve përcjellëse të dërguara nga KRU-të përmes e-mailit.

## 5. Investimet e aprovuara për KRU Gjakova

Procesi tarifor (2022-2024), bartës i të cilit është ARRU, ka një komponentë tejet të rëndësishme që janë investimet kapitale që KRU-të planifikojnë t'i realizojnë gjatë periudhës tre vjeçare. Lista e investimeve kapitale pastaj shpërndahet në kategori të caktuara sipas Udhëzuesit të Kontabilitetit Rregullator dhe si e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë në lartësinë e tarifës, rrjedhimisht edhe në të ardhurat e KRU.

ARRU ka pranuar Listën e Investimeve Kapitale të realizuara nga KRU. Duke qenë se Plani i Menaxhimit të Aseteve nuk ishte i finalizuar ende nga KRU, për të arsyetuar këtë listë të investimeve të vitit 2023, KRU sipas udhëzimeve të ARRU, për secilin projekt të propozuar ka përgatitur një arsyetim, pjesën përshkruese si dhe paramasën dhe paralogarinë për projektet e listuara.

Pas pranimit të aplikacionit tarifor, ARRU mbështetur në parimet bazë për përbalueshmërinë e faturës nga ana e konsumatorit dhe për të ruajtur nivelin e shërbimit të KRU-së, ka bërë ndërhyrje në vlerat e projekteve të investimeve kapitale prej burimeve vetjake. Këto ndërhyrje në tekstin e më poshtëm përkufizohen me shprehjen "Rregullimet nga ARRU". Në disa raste janë shtuar vlera të investimeve kurse në raste tjera janë zbritur vlera të investimeve.

Këto rregullime u janë dërguar KRU-së të cilës u është kërkuar që të dërgojnë e listën e azhurnuar komfor ndërhyrjeve nga ARRU. Listën e azhurnuar KRU-ja nuk e ka dërguar në ARRU, e cila gjë e ka vështirësuar analizën e realizimit të investimeve sipas projekteve.

## 6. Investimet e realizuara nga KRU-të sipas procesit të auditimit të të dhënave

Ekipi i ARRU-së për auditimin e të dhënave, pas takimit të mbajtur në KRU, ka marrë të dhënat e realizuara të investimeve kapitale nga moduli i kontabilitetit. Ato investime të cilat kanë qenë të regjistruara në modul të kontabilitetit, të cilat, njëherësh, plotësojnë kriteret për t'u regjistruar në kontabilitet, janë njohur nga ARRU si investime të realizuara për periudhën përkatëse, në këtë rast për vitin 2023.

Për nevoja të krahasimit, në tabelën vijuese do të paraqiten shumat e investimeve kapitale, të ndara sipas kategorive, ku do të jenë investimet e aprovuara nga ARRU dhe pastaj shumat e realizuara nga KRU. Realizimi i investimeve të planifikuara është bërë ndaras për investimet e financuara nga KRU dhe ndaras për investimet e financuara nga grantet (Donacionet).

Tabela 1. Investimet në shërbimet e ujësjellësit

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar		Vlera e realizuar	
			Financuar nga KRU	Grantet	Financuar nga KRU	Grantet
Resurse dhe trajtim	Infrastrukturë	Përtëritje			0.0	0.0
		Rritje			0.0	0.0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	35,000.0		0.0	0.0
		Rritje	10,000.0		109,377.0	0.0
Distribuíim	Infrastrukturë	Përtëritje	233,592.0		460,754.0	434,208.0
		Rritje	200,000.0		0.0	0.0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	124,000.0		3,600.0	0.0
		Rritje			130,156.0	12,445.0
Aktivitet Biznesor	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	375,800.0		81,681.0	0.0
		Rritje			129,665.0	0.0
<b>Totali</b>			<b>978,392.0</b>	<b>0.0</b>	<b>915,233.0</b>	<b>446,653.0</b>

Tabela 2. Investimet në shërbimet e ujërave të ndotura

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar		Vlera e realizuar	
			Financuar nga KRU	Grante	Financuar nga KRU	Grante
Grumbullim	Infrastrukturë	Përtëritje	134,000.0		0.0	0.0
		Rritje			0.0	0.0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje			0.0	0.0
		Rritje			0.0	0.0
Trajtim ujërave ndotura	Infrastrukturë	Përtëritje			0.0	0.0
		Rritje			0.0	6,323,785.0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje			0.0	0.0
		Rritje			4,141.0	9,042,281.0
Trajtim i Llumit	Infrastrukturë	Mirëmbajtje			0.0	0.0
		Rritje			0.0	0.0
	Jo infrastrukturë	Përtëritje			0.0	0.0
		Rritje			0.0	0.0
Aktivitet Biznesor	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	73,900.0		4,299.0	0.0
		Rritje			6,824.0	0.0
<b>Totali</b>			<b>207,900.0</b>	<b>0.0</b>	<b>15,264.0</b>	<b>15,366,066.0</b>




Figura 1. Grafiku i krahasimit të realizimit të investimeve të financuara nga KRU dhe nga Grantet




Figura 2. Përqindja e realizimit të investimeve kapitale

---

Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 1,186,292.00 € prej të cilave ka realizuar 1,361,886.00 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar vetëm 78 % të investimeve.

Prej burimeve të financimit nga grantet, KRU ka planifikuar 0.00€ prej të cilave ka realizuar 15,366,066.00 €.

Meqë investimet e realizuara nga tarifa janë cak i monitorimit të ARRU-së, monitorimi i investimeve në këtë proces nuk ka marrë për bazë projektet një nga një nga grantet.

## **7. Monitorimi i listës së investimeve kapitale**

Monitorimi i Listës së Investimeve Kapitale konsiston në verifikimin e projekteve të dorëzuara nga KRU sipas Listës, e cila si e tillë, përveç emrit të projektit ka edhe dokumentin mbështetës me përshkrim, arsyetim, para masë dhe para llogari të projektit të caktuar.

Ekipi nga ARRU ka diskutuar dhe vlerësuar implementimin e projekteve sipas Listës së investimeve me përfaqësuesit e KRU, prej nga ka marrë informacione rreth statusit aktual për secilin projekt.

Në tabelën 3 është paraqitur ndaras lista e projekteve për shërbimeve të ujit nga ato për shërbimet e ujërave të ndotura. Në kolonën e fundit janë komentet e ARRU-se, të marra gjatë takimit, mbi gjendjen në të cilën ndodhet secili projekt.

## SHTOJÇË. LISTA E PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE DHE STATUSI I REALIZIMIT TË TYRE

Tabela 1. Statusi i projekteve në shërbimet e ujësjellësit të financuara nga KRU

Nr	Projektet Sipas kategorive	Aprovuara nga ARRU	Realizuara nga KRU	Statusi i projektit
<b>A Përtëritja e infrastrukturës</b>				
1	Furnizimi -Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijes për të gjitha njësitë me pjesë më të mëdha se 2"(coll) dhe më të vogla se 2"(coll). Këtu hyjnë edhe Ujëmatësit e dimensioneve të mëdha dhe gypat për ndërrimin e rrjetit nëpër rrugët të cilat do të asfaltohen.	233,592	300,000	Është realizuar projekti në vitin 2023, porse ka qenë i planifikuar me 300,000 EUR.
2				
3				
<b>B Rritja e infrastrukturës</b>				
1	Furnizim me ujë të pijes: Fsh. Polluzhë, Senocë, Drenocë dhe Zona e epërme fsh. Senocë, Kom. Rahovec.	200,000	0	Në vitin 2023 nuk është realizuar. Përderisa qeveria qendrore dhe ajo lokale nuk kanë iniciuar këtë projekt.
2				
3				
<b>C Mirëmbajtja e jo-infrastrukturës</b>				
1	Furnizim me material Laboratorik, fiziko-kimik dhe bakteriologjik për nevojat e KRU Gjakova	20,000	n/a	E përfunduar. Është furnizim permanent.
2	Inventar Laboratorik	8,000	0	Në vitin 2023 nuk është realizuar ngase kishte dështuar tenderi, i njëjti është realizuar në maj të 2024.
3	Servisimi i aparaturës së Karbonit Aktiv	5,000	0	Nuk është realizuar në 2023. Ngase nuk kishte turbullira dhe nuk ka pas nevojë teknikiht. Karboni aktiv hyn në funksion veç kur ka turbullira.
4	Izolimi i rezervarit të kthines ndarëse të Stacioni i filtrave	2,000	0	Nuk është realizuar ngase nuk kishte arsye sepse nuk kishte rrjedhje.
5	Furnizim me material elektrik për nevojat e mirëmbajtjes elektrike (ndriçimi për objekte, ormanët elektrik, rele niveli, kablllo, ndërprerës automatik,	10,000	n/a	Është realizuar në 2023, dhe për afërsisht me këtë vlerë është realizuar siç ka qenë e planifikuar.
6	Furnizim dhe montimi me material elektro energjetik (tensioni i lartë) për tere sistemin (Trafot, largpërçuesit, kabllot 10 Kv etj)	25,000	0	Nuk është realizuar me arsyetimin se ka pasur prioritete në projekte tjera më të rëndësishme.
7	Mirëmbajtja e linjës 35 Kv, 10kV,trafo energjetik 35/10/0.4kV	20,000		Nuk është realizuar me arsyetimin se ka pasur prioritete në projekte tjera me të rëndësishme.
8	Servisimi i pompave dhe rimbështillja e motorëve të KRU "Gjakova"	9,000	n/a	Është përfunduar dhe vazhdimisht është punë që bëhet.
9	Mirëmbajtja e rrugës nga Rezervari Batushë deri të kaptazha (vepra marrëse) L=8000 m, dhe rregullimi i vepres marrese të burimi të ujit	60,000	26,041	Është realizuar në vitin 2023, vlera prej 26,041 euro.
<b>D Rritja e jo-infrastrukturës</b>				
1	Rrethimi i Liqenit të Radoniqit dhe kanalit	10,000		Nuk është realizuar si pasojë e

	derivues (sipas zonave mbrojtëse) L= 12.700 m			prioriteteve tjera te KRU-se.
2				
3				
<b>E</b>	<b>Aktivite biznesore</b>			
1	Furnizimi me pajisje te TI për te gjitha njësit	24,700	n/a	Janë bërë furnizimeve te IT-se.
2	Furnizim me makineri- 1 skip i madh 75 kw - 102 kw, një kamionetë e vogël, 2 gjipa , Fërgon me mjete te punës përcjellëse per defekte.	47,500	88,900	Është realizuar, janë blere dy Toyota 4x4 në vlere prej 89,800 euro.
3	Furnizimi i punëtorëve me mjete pune për të gjitha njësitë.	19,000	n/a	Është realizuar.
4	Mirëmbajtja e të gjitha objekteve ndërtimore në KRU Gjakova ( Mirëmbajtje e objekteve St. Filtrimit, Drejtoritë: (Gjakova, Rahoveci, Lumbardhi), Rezervuarët, Stacionet e pompimit (interieri -dyer, dritare, lyerja, shtylla betoni, rrethoja etj)	30,000	43,288	Është e realizuar ne Gjakove, Rahovec ne st filtrimit. Vlera 43,288.
6	Investime te marra nga shtojca e projekteve 2022-2024, jo-infrastrukture, nr. rendor I projekteve 17,20,21,22,24,25,26,27,28,29,30,31,32(95% Ujë)	254,600	n/a	n/a

Tabela 2 Statusi i projekteve në shërbimet e ujërave të ndotura të financuara nga KRU

Nr	Projektet Sipas kategorive	Aprovuara nga ARRU	Realizuara nga KRU	Statusi i projektit
<b>A</b>	<b>Përtëritja e infrastrukturës</b>			
1	Investime ne kapakët e pusetave për kanalizim	4,000	n/a	Është realizuar dhe kane marre kapakë nga tenderi për furnizim me pjese fazonike.
2	Montimi dhe sigurimi i kapakëve për puseta te kanalizimit fekal	40,000	0	Nuk është realizuar.
3	Riparimi i kanalizimit fekal Gjakovë dhe Rahovec	20,000	0	Është shpallur tenderi në 2023 dhe punimet janë në perfundim të vitit 2024, me vlere te kontraktuar prej 30,000 euro me titull sanimi i rrjetit të kanalizimit neper rrugë të ndryshme sipas rasteve të paraqitura në terren.
4	Ndërrimi i gypave të kanalizimit-Gjakovë	10,000	0	Nuk është realizuar.
5	Ndërrimi i gypave të kanalizimit-Rahovec	10,000	0	Nuk është realizuar.
6	Rregullimet nga ARRU	50,000	0	Nuk është realizuar.
<b>B</b>	<b>Rritja e infrastrukturës</b>			
1				
2				
3				
<b>C</b>	<b>Mirëmbajtja e jo-infrastrukturës</b>			
1				
2				
3				
<b>D</b>	<b>Rritja e jo-infrastrukturës</b>			
1				
2				
3				
<b>E</b>	<b>Aktivitete biznesore</b>			
1	Blerja e pajisjeve për operim dhe mirëmbajtje për dy Njësit	15,000		Është realizuar si në statusin e shërbimeve të ujit.
2	Furnizimi me pjesët rezervë (harxheve) për dy cisternat e kanalizimit	10,000	n/a	n/a
3	Furnizim me mjete pune për mirëmbajtjen e kanalizimit sipas standardeve	10,000		Është realizuar si në statusin e shërbimeve të ujit.
4	Investime te marra nga shtojca e projekteve 2022-2024, jo-infrastruktore, nr. rendor I projekteve 17,20,21,22,24,25,26,27,28,29,30,31,32 (5% kanalizim)	13,400	n/a	n/a
5	Furnizim me gyp fleksibil gome me tel çeliku me gjatësi 6 m, për dy njësit	2,000		Nuk është realizuar.

6	Furnizim me motor pompë thithëse për pastrimin e ujërave të ndotura	20,000		Është përfunduar në vitin 2022.
7	Furnizim me makineri- 1 skip i madh 75 kw - 102 kw, nje kamionet e vogël, 2 gjipa , Furgon me mjete te punës përcjellëse për defekte.	2,500		Projekt i alokuar nga shërbimet e përbashkëta, statusi i tij është në shërbimet e ujit.
8	Furnizimi i punëtorëve me vegla pune për të gjitha njësitë.	1,000		Projekt i alokuar nga shërbimet e përbashkëta, statusi i tij është në shërbimet e ujit.

---

## 8. Konkluzione

1. Gjatë procesit tarifor, KRU-ja kishte planifikuar investime në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujësjellësit, por nuk i ka realizuar ato, edhe pse janë në procedurë.
2. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 1,186,292.00 € prej të cilave ka realizuar 1,361,886.00 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar vetëm 78 % të investimeve.
3. Prej burimeve të financimit nga grantet, KRU ka planifikuar 0.00€ , kurse ka realizuar 15,366,066.00 €.
4. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit kompania nuk i ka realizuar sipas planifikimeve. Kjo kategori e investimeve ka shumë rendësi në nivelin e shërbimit, njëherësh ka ndikim direkt edhe në tarifa.
5. Në kategorinë e investimeve në infrastrukturën e ujërave të ndotura, me mjetet vetjake të financimit, KRU nuk ka bërë investime sipas planifikimeve.
6. Ngecja e mos realizimit të investimeve kapitale ishte ndikuar nga vonesat në procedurat e prokurimit, problemet financiare, ndërrimeve në menaxhmentin e KRU-së etj.
7. Ka mangësi tek kontimi i shpenzimeve të ujërave të ndotura, rezultuar jo reflektuese.
8. Ngecë mbështetja e plotë në Planin e Menaxhimit të Aseteve(PMA), duke rezultuar me planifikim jo të mirë sipas prioriteteve të projekteve të investimeve kapitale, njëherësh, edhe arsyetimi i projekteve ka pasur mangësi.
9. Ofruesi i shërbimeve nuk ia del që ta ketë bërë Planifikim të Investimeve Afatgjata(PIA). Po ashtu edhe kjo e ka kufizuar burimin për një plan të mirë biznesi.
10. Ofruesi i shërbimeve nuk ia doli, që të sjellë Plan Biznesi të njëjtë në ARRU, sikurse në NPMNP.
11. Ofruesi i shërbimeve, dështon që të kërkojë nga ARRU aprovimin e ndryshimeve në projektet e aprovuara me BPRR.
12. Vërehet përmirësim i dukshëm nga e kaluara.
13. ARRU, në këtë raport, nuk ka kalkuluar 'Investimet në Vijim' dhe indeksimin për normën e inflacionit, duke rezultuar, në dukje me më pak investime nga tarifa e shërbimit.
14. Përr gjithë këto mangësi, ARRU ka shprehur shqetësimin e vet tek menaxhmenti i KRU-së, Bordi dhe aksionari, duke pritur reflektimin e tyre.

---

## 9. Rekomandime

15. Ofruesi i shërbimeve duhet që ta njëjtësoj Planin e Biznesit të ARRU-së me atë të NPMNP-s
16. Ofruesi i shërbimeve duhet ta harrojë praktikën e mos dorëzimit në ARRU 'Listën e azhurnuar të Investimeve kapitale', pas ndërhyrjeve rregullatorë.
17. Ofruesi i shërbimeve duhet që ta përmirësojë cilësinë e Plan Biznesit, duke u mbështetur në Planin e Menaxhimit të Aseteve dhe PIA;
18. Investimet e pa realizuara kapitale, gjatë viteve vijuese, në procesin e ardhshëm tarifor 2026-2028, ARRU do të ndërmerr veprime rregulluese sipas Rregullores Nr.12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.
19. Rekomandojmë që KRU të jetë e vëmendshme, që për shkaqe të procedurave të prokurimit, problemeve financiare, ndërtimeve të fundit të menaxhmentit, që të angazhohet, që këto të mos ndikojnë në mos realizimin e investimeve kapitale.
20. Rekomandohet KRU-ja që të angazhohet më shumë në azhurnimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve, i cili pasqyron gjendjen reale të asetëve të kompanisë.
21. Rekomandohet KRU-ja që të ketë koordinim më të mirë me Komunën dhe Donatorët e tjerë në mënyrë që planifikimet të bëhen me kohë dhe sipas prioriteteve dhe të përfshihen saktë në aplikacionin tarifor.
22. Rekomandojmë KRU-në, që të bëj planifikim të saktë sipas nevojave prioritare, që shpijnë kah eficienca më e mirë dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit
23. Rekomandohet që ofruesi i shërbimeve, që të jetë i vëmendshëm në investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit, kompania t'i realizojë sipas planifikimeve. Kjo kategori e investimeve, për ARRU, ka shumë rëndësi në nivelin e shërbimit, njëherësh ka ndikim direkt edhe në tarifa. Praktika e deritanishme nuk do të tolerohet nga Autoriteti.
24. Rekomandojmë ofruesin e shërbimeve që ta hartoj 'Planin e Investimeve Afatgjata', sa më parë që është e mundur.
25. Rekomandohet ofruesi i shërbimeve që, të mos bëjë asnjë ndryshim të projekteve nga BPRR, pa aprovimin e Autoritetit.
26. Rekomandohet kompania që t'i evitoj këto mangësi, në të kundërtën, Autoriteti do t'i ndërmerr veprimet, që kanë influencë në tarifa, nivelin e shërbimeve, etj.

*Ky raport u punua nga:  
Departamenti i Tarifave të ARRU*

**Investimet kapitale gjatë vitit 2023 /Vetjake dhe bashkëfinancim me Komuna/ donacionet e KFW, dhe Qeveria e Kosovës**

Emri i Projektit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i kontraktuar	Dëshmi mbi punimet e realizuara
2021-2023. Dislokimi dhe ndërrimi i gypit nga AC në PE për fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol	Bashkëfinancim: Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit: 350,000.00 € KRU "Gjakova": 106,397.61 € + Punët shtesë: 39,957.07 € Total: 146,354.68€	O Ekonomik Lulzim Beqiraj B.I.: Fidani-Beton	Është pranuar teknikisht me datë: 24.05.2023
Renovimi, mirëmbajtja e objekteve ndërtimore të KRU Gjakova	Vetëfinancim KRU "Gjakova" Vlera financiare: 43,228.84€	OE " Eko Term " SH.P.K.,	Është pranuar teknikisht me datë: 24.03.2023
Furnizimi dhe montimi i portave kryesore në pendën e Llukës	Vetëfinancim KRU "Gjakova" Vlera financiare: 44,500.00 €	OE N.P.T. Xërxa Rahovec	Ekziston raporti i pranimit teknik Maj, 2023
Rehabilitimi i ujësjellësit – Stacioni i pompimit dhe furnizimi me ujë të pijshëm për fshatin Randobravë	Bashkëfinancim: KRU "Gjakova": 28,540.19 € Komuna e Prizrenit: 27,420.97 € Total: 55,961.17€	OE N.P.T. Xërxa Rahovec	Është pranuar teknikisht me datë: 27.09.2023
Ndërrimi i gypave të ujësjellësit nga AC në PE100 RC, prej gjykatës deri te Emin Duraku.	Bashkëfinancim: KRU "Gjakova": 115,496.05 € Punë shtesë: 19,548.60€ Komuna e Gjakovës: 110,966.80 € Total: 246,011.50€	OE N.P.T. "Xërxa", Rahovec	Është pranuar teknikisht me datë: 19.12.2023
Furnizim me 6 filtra të shpejte për stacionin e filtrimit Batushë	Vetëfinancim KRU "Gjakova" KRU "Gjakova": 35,075.00 €	OE Geo Group Ing SH.P.K. Gjakovë	Raporti i pranimit te furnizimit është bërë me datë:11.10.2023
Renovimi i Objektivit Administrativ Prizren	Vetëfinancim KRU "Gjakova" KRU "Gjakova": 42,422.42 €	OE Triangle SH.P.K,	Është pranuar teknikisht me datë: 15.12.2023
Sanimi i rrjetit të kanalizimit nëpër rrugë të ndryshme, sipas rasteve të paraqitur në terren	Vetëfinancim KRU "Gjakova" KRU "Gjakova": 30,000.00 €	OE Kosova Water & Energy Sh.p.k	Punët gjinden ne vazhdim e sipër përfundojnë ne Maj 2024
Ndërrimi i gypave nga AC në PE për tre rrugët e Komunës së Rahovecit	"KRU "Gjakova": 16,997.17 € Komuna e Rahovecit: 16,330.62 € Total: 33,327.79 €	KRU Gjakova	Është pranuar teknikisht me datë: 15.12.2023
Rrethimi i veprës marrëse te burimi në bjeshkën e Babaj Bokës".	Vetëfinancim KRU "Gjakova" KRU "Gjakova": 26,041.00 €	Grup i Operatorëve Ekonomik Marisa SH.P.K.; N.SH.T. VIKTORY COM	Është pranuar teknikisht me datë: 28.12.2023
Ndërrimi i gypave te rrjetit ujësjellësit nga AC në PE, nga Emin Duraku deri ne fshatin	Bashkëfinancim: KRU "Gjakova": 166,553.63 € Komuna e Gjakovës: 160,022.11 €	"V- SHEHU" SH.P.K,	Punët gjinden ne vazhdim e sipër dhe pritet te

Osek Hyle.	Total: 326,575.74€		përfundojnë ne Maj 2024
2021-2023. Përmirësimi i Furnizimit me Ujë dhe Mbrojtja e Resurseve Ujore për Kompaninë e Ujësjetës Rajonal të Gjakovës: Studimi i Fizibilitetit VNMS, Projektimi i Detajuar	Asistenca teknike: Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) Financues: Banka Evropiane për Zhvillim. Vlera financiare: 900,000.00 €	Kontraktuesi është COWI/SPI, A/S, Parallelvej 2, 2800 Kongens, Lyngby, Denmark Nënkontraktori Infra-Plus-Prishtinë.	Ka përfunduar me 8 Qershor 2023
Faza – III / Work Contract Nr-2” Impianti i Trajtitimit të ujërave të ndotura ITUN Gjakova , bazuar ne Librin e Verdhe të FIDIC-ut	Projekti i ITUN u zbatua në kuadër të Bashkëpunimit Zhvillimor ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë përmes Bankës Zhvillimore KFW dhe Konfederatës Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO) dhe Komuna e Gjakovës Kontrata WC 2 (Work contract - kontratë pune), Kontrata bazë: 7,270,630.51	WC 2. Kontraktori: PASSAVANT WC 02 Nënkontraktori: KWE	Me datë 11.05.2023 është mbajtur ceremonia e inaugurimit të ITUN-it
Faza – III / Work Contract Nr-1” Addendum Nr.3	Projekti i ITUN u zbatua në kuadër të Bashkëpunimit Zhvillimor ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë përmes Bankës Zhvillimore KFW dhe Konfederatës Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO) dhe Komuna e Gjakovës Vlera financiare: 5.410.916, 73€	WC 1. Addendum 3 Kontraktori: KWE	Vazhdojnë punimet deri me 04 / 02 / 2024
Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë Faza V-VI	Investimi është grant i pakthyesëm nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW. Kontrata ka vlerë prej 4,191,238.42€.	O E: Alb Star Sh.p.k Nënkontraktori: KWE	Projekti ka filluar me 21.11.2022 është ne realizim dhe vazhdon deri ne Maj 2024